



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr. 10, Tel: 04 227 84 50, Tiranë - Albania

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2011

Lënda: Dërgohet Rekomandimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi pas shqyrtimit të ankesës së LBGT PRO/PINK Embassy.

Drejtuar: **Z. Et'hem RUKA**
Kryetar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
Kuvendi i Shqipërisë

Z. Tritan SHEHU
Nënkryetar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
Kuvendi i Shqipërisë

Për dijeni: **Zj. Jozefina TOPALLI**
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

TIRANË

Të nderuar Zotërinj,

Mbështetur në nenin 32, gërma a) dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10 021, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar ankesën e LBGT PRO/PINK Embassy, ku pretendohet për diskriminim të tyre dhe komunitetit që ata përfaqësojnë, nga ana e Nënkyetarit të Komisionit për Punën dhe Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë, Z. Tritan Shehu.

Sipas ankesës së sipërpërmendur, diskriminimi i këtij komuniteti dhe përfaqësuesve të LBGT PRO/PINK Embassy, konsiston :

Së pari, në deklaratën e dhënë nga Z. Tritan Shehu, gjatë seancës dëgjimore të datës 01.12.2010 të Komisionit, ku ndër të tjera është shprehur dhe e ka konsideruar homoseksualitetin si sëmundje, deklaratë e cila është cilësuar si fyese, diskriminuese dhe denigruese për Komunitetin LGBT në Shqipëri;

Së dyti, në pengimin e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të LGBT PRO/PINK Embassy, në seancën dëgjimore me grupet e interesit për ditën ndërkombëtare kundër SIDËS, të Komisionit për Punën dhe Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë, që është zhvilluar në datën 01.12.2010.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32-33 të Ligjit nr. 10 021, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndoqi procedurat përkatëse për trajtimin e ankesës së sipërpërmendur:

1. U njoftuan subjektet ndaj të cilëve është bërë ankese duke u kërkuar njëkohësisht informacion shpjegues nga pala ankimuese dhe pala ndaj së cilës ishte drejtuar ankesa, si dhe më pas u mbledhën edhe fakte të tjera të lidhura me çështjen në fjalë, të cilat u studiuan dhe analizuan më kujdes nga strukturat përkatëse të Komisionerit.
2. Komisioni Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë nuk i është përgjigjur shkresës dt.21.12.2010, përmes së cilës Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi njofton dhe kërkon shpjegime nga ky komision për çështjen në fjale. Të dhënat për seancën dëgjimore janë siguruar nëpërmjet faqes së internetit të Kuvendit të Shqipërisë.
3. Me shkresë dt. 04.01.2011 Z. Tritan Shehu i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me informacionin shpjegues, ku ndër të tjera përmendet fakti se deklaratat dhe reagimet e tij nuk kanë pasur qëllim diskriminues ndaj komunitetit LGBT, pavarësisht se ato janë kuptuar dhe konsideruar si të tilla nga përfaqësuesit e LGBT PRO/PINK Embassy. Njëkohësisht, Z. Shehu thekson se ka shprehur mendimin e tij si deputet, dhe si i tillë nuk është i detyruar të japë shpjegime për ato që thotë në kryerje të funksioneve të tij.

Ne shkresën në fjale Z. Shehu shpreh: *“mendimet dhe opinionet e mia personale për homoseksualitetin, transeksualitetin etj, si fenomene në mospërputhje me normen, qendrimin tim të vendosur për ruajtjen e perberjes së familjes prej burrit dhe gruas, për mosdhenien e të drejtës së adoptimit të fëmijëve çiftëve homoseksuale, transeksuale, unë i kam shprehur publikisht.”*

4. Për sa i përket pikës së dytë të ankesës së LGBT PRO/PINK Embassy, Komisioneri ka kryer verifikime të tjera, duke patur si synim të qartësonte çështjen në fjalë.

- Komisioneri me shkresë të vecante dt. i ka kërkuar LGBT PRO Shqipëri kërkesën zyrtare që kjo organizatë i ka dërguar Komisionit Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, ku i kërkon zhvillimin e një seance dëgjimore për shëndetin, mirëqenien situatën dhe respektimin e të drejtave të personave që jetojnë me HIV/AIDS në Shqipëri.

- Ne shkresen kerkese dt.08.11.2010, LGBT PRO Shqiperi drejtuar Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë, nenvizon edhe qellimin qe do te kishte kjo séance sipas tyre: “ *...te diskutojne ne lidhje me shendetin, mireqenien, situaten dhe respektimin e te drejtave te personave qe jetojne me HIV/AIDS ne Shqiperi.*”
 - Theksojme se seanca dëgjimore me grupet e interesit per ditën ndërkombëtare kundër sidës është realizuar me dt.30.11.2010 dhe jo me dt.01.12.2010 sic rezulton ne ankesen e LGBT PRO/PINK Embassy.
 - Në shkresen dt. 04.01.2011 të Z. Tritan Shehu drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Z.Shehu thekson se: “... *mbledhja e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë e dates 30.11.2010 nuk eshte organizuar ne bazë te ndonje kerkese nga ajo apo tjetër ofj, por me kerkese dhe vendim të vetë komisionit*”.
 - Sipas procesverbalit të seancës dëgjimore me grupet e interesit për ditën ndërkombëtare kundër SIDËS, të Komisionit për Punën dhe Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë, e cila është realizuar në datën 30.11.2010, *rezulton se janë ftuar 2 (dy) përfaqësues të Institucionit të Shëndetit Publik, 1 (një) përfaqësues i Shoqatës së Talasemikëve dhe 1(një) përfaqësues i Shoqatës së Njerëzve që jetojnë më HIV-AIDS.*
5. Në procesverbalin¹ e sipërpërmendur, sipas të dhënave të paraqitura nga Z. Enver Roshi, Drejtor i Institutit të Shëndetit Publik, rezulton se në Shqipëri predominon rruga seksuale e transmetimit të virusit HIV-AIDS, në total 92% ku 81% i përket rrugës heteroseksuale dhe 11% homo-biseksuale. Këto të dhëna janë tepër domethënëse, sidomos për sa i përket përqindjes së konsiderueshme që zë transmetimi homo-bioseksual i HIV-AIDS.
6. Ne kete kontekst nga procesverbali i séances degjimore konstatohet se Z. Shehu ka vleresuar faktin se: “ *Ka ardhur momenti qe popullata te ndergjegjesohet se homoseksualiteti eshte nje element i cili shton virusin HIV/AIDS*”.

Sa me siper:

- Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 18 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 14 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10 021, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe Rekomandimin² nr. 11, të Komisionit European, të inkorporuar në Progres-Raportin e KE-së për vitin 2010, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese, sidomos për sa i përket komunitetit LGBT, në Shqipëri.

¹ Faqja e dytë e procesverbalit të seancës dëgjimore publike, të datës 30.11.2010 – www.parlament.al

² Progres-Raporti i KE-së për vitin 2010, Rekomandimi 11- Forcimi i mbrojtjes së drejtave të njeriut :

“Të bëhen hapa konkretë në forcimin e mbrojtjes e të drejtave të njeriut, sidomos të grave, fëmijëve dhe romëve, si dhe në zbatimin e efektshëm të politikave anti-diskriminim.”

- Duke marrë parasysh involvimin direkt që përfaqësuesit e LGBT PRO/PINK Embassy kishin në këtë çështje, numrin të konsiderueshem të të infektuarve me HIV-AIDS, si pasojë e transmetimit homo-bioseksual të virusit, si dhe dëshirës që ata kishin shfaqur për pjesëmarrje në këtë seancë dëgjimore, pasqyruar ne kerkesen drejtuar Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë

Duke patur ne vemendje:

- Në nenin 36, pika 1, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë parashikohet se : ***“Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara. Komisioni është i detyruar të realizojë seancën dëgjimore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, në rast se një e treta e të gjithë anëtarëve të komisionit e kërkon atë në mënyrë të motivuar me shkrim”***.
- Në nenin 73, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: ***“Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe për votat e dhëna prej tij.”***, sikurse edhe në bazë të nenit 4, pika 3, të ligjit nr. Nr.8550, datë 18.11.1999, “Statusi i Deputetit”, i ndryshuar, përcaktohet se: ***“Deputeti ka të drejtë të shprehë lirisht mendimet e tij,”***.

Mbështetur në nenin 32, gërma f) të Ligjit nr. 10 021, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet shprehimisht ***kompetenca e Komisionerit për të kryer rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin***, si dhe duke patur si qëllim në vetëvete mirëbesimin dhe krijimin e marrëdhënieve sa më normale, të mbështetura në parimin e barazisë dhe aspak diskriminuese, ndërmjet Komunitetit LGBT dhe institucioneve shtetërore,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi :

REKOMANDON :

1. Evitimin e deklaratave me nota diskriminuese në të ardhmen, të cilat ndikojnë në krijimin e një atmosfere të tensionuar dhe jo miqësore me komunitetin LGBT në Shqipëri.
2. Dhënia e të gjitha garancive të mundshme që mendimi, opinionin dhe fjala e tyre të dëgjohet vlerësohet dhe të merret në konsideratë, kur ata janë të involvuar në mënyrë direkte në çështje të caktuara për të ndihmuar këto komunitete të gezoje normalisht të drejtat dhe liritë e tyre.
3. ***Ne këte kuadër, Ju informojmë se në bazë të verifikimeve të kryera rezulton se homoseksualiteti është përjashtuar nga (ICD-10) Klasifikimi Ndërkombëtar i Sëmundjeve,***

në Asamblenë e 43-të Botërore të Shëndetit, që është organizuar në Maj 1990 dhe nuk duhet te trajtohet si i tille.

Për sa më sipër, shpresojmë dhe besojmë në një bashkëpunim sa më të frytshëm ndërmjet institucioneve tona në të ardhmen, duke e vlerësuar maksimalisht mirëkuptimin Tuaj, në mënyrë që institucioni i ri i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të kryejë detyrat e tij funksionale, në mënyrë sa më korrekte dhe konform ligjeve dhe akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj,

Irma BARAKU

KOMISIONERI

